

TAKIMI I TRETË 2022 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **20.10.2022**.

Gjatë mbledhjes u prezantuan dhe u diskutuan dy çështje kryesore:

- Prezantimi i ofertës ekzistuese të AFP-së në TIK
- Diskutimi mbi gjetjet e Studimit të Nevojave për Aftësi (SNA) të tregut të punës në fushën TIK

Prezantimi i ofertës ekzistuese të AFP-së në TIK

Pjesa e parë e mbledhjes u përqëndrua në prezantimin e ofertës arsimore të TIK dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Gjatë prezantimit, Sekretariati Teknik evidentoi se, në nivelin e V të KSHK nuk kishte kualifikime të TIK, prandaj u theksua nevoja për identifikimin e kualifikimeve për këtë nivel. Sekretariati sqaroi se, të gjithë individët që përfundonin nivelet e arsimit profesional pajiseshin me certifikatë në nivelin përkatës sipas KSHK, duke theksuar se KSHK ishte referencuar me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK). Gjithashtu, Sekretariati sqaroi se, kurset nuk ishin ende pjesë e KSHK-së, por ishte në proces përgatitja e bazës ligjore për përfshirjen e tyre në kornizë.

Gjatë prezantimit u vu në dukje se, kualifikimi profesional *“Inxhinieri informatike software-ike”* nuk kishte një prezantim tek sektori privat dhe se kjo kërkonte një mënyrë më të mirë promovimi.

Diskutimi mbi gjetjet e Studimit të Nevojave për Aftësi të tregut të punës në fushën TIK

Në vijim të mbledhjes u prezantuan gjetjet e Studimit të Nevojave për Aftësi të tregut të punës, ku u theksua se studimi, në nivel makro, ishte i vetmi i disponueshëm në treg dhe vlerësohej si mjaft i pasur, i thelluar, i përdorshëm dhe i domosdoshëm. Sekretariati theksoi se, ishte i rëndësishëm prezantimi dhe validimi i gjetjeve të përfshira në Studimin e Nevojave për Aftësi. U kërkua kontributi i anëtarëve lidhur me mënyrat e pasurimit të studimit, në mënyrë që gjetjet dhe rekomandimet të pasqyroheshin në ofertën e AFP-së dhe në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, për përditësimin e tij në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Gjatë diskutimeve për gjetjet e Studimit të Nevojave për Aftësi, anëtarët dolën në konkluzionin se inteligjenca artificiale ishte një kualifikim shumë i kërkuar. Anëtarët shtuan se, studimi duhet të analizohej me kujdes në lidhje me teknologjitë e reja, risitë që kërkonte tregu dhe mënyrën e përfshirjes së tyre në kualifikimet profesionale.

U theksua se, mund të kishte risi që ende nuk kishin hyrë në Shqipëri dhe që duheshin përfshirë në studim, si p.sh. platformat online që përdoreshin jashtë vendit.

Anëtarët validuan gjetjet dhe rekomandimet e Studimit të Nevojave për Aftësi.